



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ENTI RREGULLATOR PER FURNIZIMIN ME UJE DHE LARGIMIN E PERPUNIMIN E  
UJRAVE TE NDOTURA

# **RAPORTI VJETOR**

# **2010**

**GJENDJA NE SEKTORIN UJESJELLES - KANALIZIME DHE VEPRIMTARIA E  
ENTIT RREGULLATOR TE UJIT**



## PERMBAJTJA

|                                                                          | Faqe      |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------|
| ➤ Vizioni, Misioni dhe Rruget se si mund te shkojme drejt tyre.          | 5         |
| <b>1. Fjala e Kryetarit</b>                                              | <b>6</b>  |
| <b>2. Autoriteti Rregullator i Ujit</b>                                  | <b>8</b>  |
| 2.1 Statusi Ligjor dhe Pergjegjesite                                     | 8         |
| 2.2 Aktivitetet Rregullatore                                             | 9         |
| • Licencimi                                                              | 9         |
| • Vendosja e Tarifave                                                    | 11        |
| • Vendosja e Standarteve                                                 | 14        |
| • Analiza e Sektorit                                                     | 16        |
| 2.3 Perfshirja e Konsumatoreve dhe Transparenca ne procesin Rregullator. | 17        |
| 2.4 Aktivitetet per Konsolidimin Institucional.                          | 18        |
| 2.5 Marredheniet e Jashtme                                               | 19        |
| • Bashkepunimi me Institucionet ne Shqiperi                              | 19        |
| • Bashkepunimi me Donatoret e Huaj                                       | 20        |
| • Bashkepunimi me Rregullatoret Nderkombetare                            | 20        |
| • Takime Pune dhe Konferenca                                             | 21        |
| • Marredheniet me Median.                                                | 21        |
| 2.6 Situata Financiare e ERRU                                            | 23        |
| <b>3. Gjendja e Sektorit Ujesjelles - Kanalizimeve.</b>                  | <b>24</b> |
| <b>4. Kendveshtrimi per vitin 2011.</b>                                  | <b>32</b> |
| <b>5. Rekomandime</b>                                                    | <b>33</b> |

**LISTA E GRAFIKEVE**

|           |                                                | <b>Faqe</b> |
|-----------|------------------------------------------------|-------------|
| Grafiku 1 | Situata aktuale e liçencimit.                  | 10          |
| Grafiku 2 | Situata e liçencimit ne vite.                  | 10          |
| Grafiku 3 | Tarifat per ujin e pijshem.                    | 11          |
| Grafiku 4 | Tarifat per ujin e ndotur.                     | 11          |
| Grafiku 5 | Te ardhurat vjetore te realizuara              | 23          |
| Grafiku 6 | Tendenca e humbjeve ne vite.                   | 26          |
| Grafiku 7 | Humbjet krahasuar me vendet e tjera te Europes | 27          |
| Grafiku 8 | Nr. i shoqerive sipas normes se arketimit      | 28          |
| Grafiku 9 | Struktura e shpenzimeve ne sektorin UK         | 29          |

**LISTA E TABELAVE**

|          |                                                    |    |
|----------|----------------------------------------------------|----|
| Tabela 1 | Treguesit kryesore te performances (TKP)           | 16 |
| Tabela 2 | Trendi i treguesve te performances                 | 25 |
| Tabela 3 | Konsumi i matur                                    | 27 |
| Tabela 4 | Analiza e mbulimit te kostove sipas arketimeve     | 29 |
| Tabela 5 | Struktura e te ardhurave te operatoreve UK ne vite | 30 |
| Tabela 6 | Investimet ne sektorin UK                          | 31 |

**ANEKSET**

|            |    |
|------------|----|
| Aneksi 1   | 34 |
| Aneksi 2   | 35 |
| Aneksi 3   | 37 |
| Aneksi 4   | 39 |
| Aneksi 5.1 | 40 |
| Aneksi 5.2 | 41 |

**SHKURTIMET**

|             |   |                                                          |
|-------------|---|----------------------------------------------------------|
| TKP         | - | Treguesit Kryesor te Performances                        |
| KKRR        | - | Komisioni Kombetar Rregullator i Ujit                    |
| GTZ         | - | Agjensia Gjermane per Bashkepunim Teknik                 |
| GIZ         | - | Agjensia Gjermane per Bashkepunim Nderkombetar           |
| OFWAT       | - | Autoriteti Rregullator i Ujit ne Britanine e Madhe       |
| ADA         | - | Agjensia Austriake per Zhvillim Nderkombetar             |
| DPUK        | - | Drejtoria e Pergjithshme Ujesjelles Kanalizime           |
| Ballkan NET | - | Organizata e Bashkepunimit Rajonal                       |
| MPPT        | - | Ministria e Puneve Publike dhe Transportit               |
| METE        | - | Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes         |
| MF          | - | Ministria e Financave                                    |
| MMPAU       | - | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave |
| MSH         | - | Minnistria Shendetsise                                   |
| ISHP        | - | Instituti i Shendetit Publik                             |
| USAID       | - | Agjensia Amerikane per zhvillim Nderkombetar             |
| SHUKALB     | - | Shoqata Ujesjelles Kanalizime e Shqiperise               |
| ERSAR       | - | Autoriteti Rregullator per Uje dhe Mbeturina (Portugali) |
| ZRRUM       | - | Zyra Rregullatore per Ujesjelles dhe Mbeturina (Kosove)  |
| Sektori UK  | - | Sektori Ujesjelles Kanalizime                            |
| UK          | - | Ujesjelles Kanalizime                                    |

## Vizioni

Nje sektor ujesjelles-kanalizimesh financiarisht i vete-qendrueshem qe ofron sherbime te nje cilesie te larte, por te perballueshme, per te gjithë konsumatorët ne Shqiperi.

## Misioni

Te siguroje te gjithë konsumatorët ne Shqiperi, qe ofruesit e sherbimit te furnizimit me uje dhe kanalizimeve te japin cilesine me te mire te mundshme, me nje çmim te arsyeshem dhe ne nje menyre te qendrueshme financiarisht.

## Si do ta arrijme ne kete ?

- Permes rregullimit te ofruesve te sherbimit ne sektorin e ujesjelles-kanalizimeve ne Shqiperi, ne perputhje me mandatin tone ligjor dhe synimit per te arritur nivelin me te larte ne rolin tone rregullator.
- Mbrojtja e konsumatoreve eshte thelbi i punes tone. Ne vendosim stimuj qe inkurajojne efikasitetin dhe permiresimet e ofrimit te sherbimit ne te mire te konsumatoreve, dhe veprojmë si ndermjetes ne procedurat e ankesave.
- Permes arritjes se synimit per t'i mbeshtetur shoqerite e ujesjelles-kanalizimeve te arrijne qendrueshmeri financiare dhe duke perdorur standardet e krahasimit per te percaktuar objektiva performance sfiduese, por te arritshme.
- Permes marrjes parasysh te pikepamjeve te gjithë aktoreve dhe bashkeveprimit me te gjitha palet e interesuara per te nxitur zhvillimin e sektorit ujesjelles-kanalizime.
- Permes informacionit rreth situates aktuale te sherbimeve te ujit dhe nje analize te zhvillimeve ne sektor.
- Permes shembujve nga praktikat me te mira kudo qe eshte e mundur.
- Permes permbushjes se rolit tone rregullator ne menyre transparente, te parashikueshme dhe jo diskriminuese.

## 1. **Fjala e Kryetarit,**

*Dymbedhjete vjet nga themelimi, organizimi dhe funksionimi, Autoriteti Rregullator i Ujit (ERRU), ka intensifikuar punen e tij dhe perpjekjet per permbushjen e funksioneve dhe misioneve te percaktuara ne ligj.*

*Per here te pare, ne vitin 2010, ERRU formuloi Vizionin dhe Misionin e tij per serkorin e furnizimit me uje dhe kanalizime ne Shqiperi. Ne punen e veprimtarine e tij vjetore ERRU ka synuar ne vazhdimesi zhvillimin e nxitjen e politikave rregullatore per vendosjen dhe forcimin e veprimtarise se gjithë operatoreve qe operojne ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujerave te ndotura, brenda kuadrit ligjor dhe permiresimin e pareshtur te sherbimeve ndaj konsumatoreve.*

*Liçencimi i operatoreve ka shenuar nje zhvillim shume pozitiv si pasoje e kembenguljes se vazhdueshme te Entit dhe rritjes se pergjegjshmerise se operatoreve per plotesimin e ketij detyrim ligjor. Ne sektorin UK operojne 56 operatore, nga te cilet jane liçencuar 43 dhe vetem ne vitin 2010 ERRU liçencoi 19 operatore.*

*Ne miratimin e 25 tarifave te reja gjate ketij viti, Komisioni mbeshtetur ne vizionin dhe misionin, ka synuar nxitjen dhe permiresimin e situates financiare te operatoreve, me qellimin permiresimin e sherbimit ndaj konsumatoreve.*

*Nje aktivitet i rendesishem ne bashkepunim me METE, ishte hartimi i modelit te kontrates ndermjet ofruesve te sherbimeve dhe konsumatoreve, e cila ka per qellim garantimin e nje standarti evropian per te rregulluar marredheniet mes ketyre dy partnereve, brenda kushteve te vendit tone.*

*Gjate vitit 2010, ERRU ka qene teper aktive ne permbushjen e detyrave keshilluese sipas dispozitave qe i ngarkon ligji si Rregullator, ne procesin e diskutimit te Strategjise se sektorit si dhe ne diskutimet per mekanizmin e financimit te operatoreve dhe Masterplanin per sektorin, po keshtu edhe ne permirsimin e standarteve te punes dhe sherbimit.*

*Gjate vitit te fundit, ERRU ka thelluar bashkepunimin me Institucione Kombetare, veçanerisht me: Ministria e Puneve Publike Transportit; Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave; Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (METE); Ministria e Shendetsise (MSH), Shoqata e Ujesjelles Kanalizimeve te Shqiperise; Ministrine e Financave (MF).*

*Ne kemi rritur e forcuar me tej autoritetin e ketij institucioni duke zhvilluar nje sere trajnimesh brenda dhe jashte vendit, duke marre pjese ne konferenca dhe workshope tematike, si dhe nepermjet nenshkrimet te marreveshjeve te bashkepunimit me institucione nderkombetare. Gjithashtu kemi perfituar nga shkembimi i ekperiences dhe bashkepunimit me Inistitucionet rregullatore nderkombetare te disa vendeve si: Angli, Portugali, Lituani, Kosove.*

*Gjate kesaj periudhe sektori i furnizimit me uje dhe kanalizime ka patur zhvillime te rendesishme ne drejtim te permiresimit te situates.*

*Nga te dhenat e disponuara nga ofruesit e sherbimit UK, konstatojme se veçanerisht ne 5 vitet e fundit eshte shenuar progres dhe permiresim i vazhdueshem ne disa tregues, nder te cilet mund te permendim:*

- Zonen e mbulimin e sherbimit,
- Nivelin e faturimit,
- Nivelin e arketimit,
- Standartet e sherbimit,

*Progres, por me modest eshte shenuar per treguesit si:*

- Shkalla e mbulimit te trajtimit te ujrave te ndotura,
- Niveli i matjes se ujit nepermjet matesave,
- Kohezgjatja e furnizimit me uje,
- Eficensa e stafit te operatoreve,

*Krahas treguesve te permiresuar, duhet te theksojme se niveli i humbjeve vazhdon te jete ende i larte. Nuk duhet te kenaqemi me treguesit e arritur por te fokusohemi ne gjetjen e kursit qe do te ndiqet ne vitet e ardhshme per nje permiresim me te mire te sherbimit te sektorit te furnizimit me uje dhe kanalizimeve.*

*Ne shpresojme qe te gjitha se bashku do te rrisim perpjekjet per:*

- Uljen e humbjeve,
- Permiresimin e standarteve te sherbimit,
- Licencimin e te gjitha operatoreve,
- Rritjen e efciences se operatoreve,
- Krijimin e kushteve per nxitjen e pjesmarrjes se investimeve private ne sektor.

*Se fundmi, do doja te shfrytezoja rastin per te falenderuar Anetaret e Komisionit Kombetare Rregullator per angazhimin e tyre maksimal per vitin 2010, qe permes vendi-marrjes mundesuan dhe nxiten permiresimin e performances ne sektor.*

*Une do te doja te falenderoj stafin e ERRU per perkushtimin dhe seriozitetin ne permbushjen e detyrave te saj qe me profesionalizem ka mbeshtetur Komisionin ne vendim-marrje. Ne vecanti, une do te doja te vleresoja kontributin e Qeverise Shqiptare per rolin e saj mbeshtetes ne konsolidimin e ERRU.*

*Falenderojme ne menyre te vecante, Qeverine Gjermane per mbeshtetjen e madhe ne forcimin dhe konsolidimin e ERRU permes projektit te zbatuar nga GTZ.*

*Njekohesisht, une do te doja te falenderoj te gjitha institucionet vendore dhe nderkombetare dhe donatoret per bashkepunimin dhe kontributin e dhene ne permbushjen e shume prej objektivave te perbashketa ne dobi te operatoreve dhe te konsumatoreve.*

*ERRU, do te vazhdoje te jete nje aktor teper aktiv ne zhvillimin e sektorit te ujesjelles kanalizimeve ne vend.*

*Avni Dervishi*

*Kryetar i ERRU*

## 2. Autoriteti Rregullator i Ujit

### 2.1 Statusi ligjor dhe pergjegjesite

**Enti Rregullator i Ujit** eshte institucion i pavarur publik, i krijuar me ligj per rregullimin e sektorit te furnizimit me uje, te largimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura.

**Kuadri Ligjor** i funksionimit te Entit Rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura (ERRU) eshte **ligji Nr. 8102**, dt. 28.03.1996 "Mbi kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura" i ndryshuar me ligjin Nr. 9352, dt. 03.03.2005 dhe ligjin Nr. 9584 dt. 17.07.2006 si dhe Ligjin Nr. 9915 date 12.05.2008.

**Objektivi kryesor** i ketij Ligji eshte garantimi dhe mbrojtja e interesave publike nga njera ane dhe krijimi i nje mjedisi transparent ligjor dhe rregullator, nga ana tjetere qe te nxise investimet ne kete sektor.

**Detyrat e pergjithshme te ERRU** ne perputhje me ligjin jane:

- Te nxise eficencen dhe perdorimin me efikasitet te ujit,
- Te beje te mundur qe te licencuarit te financojne veprimtarite e autorizuar nga Licenca,
- Te mbroje interesat e konsumatoreve ne lidhje me cimet dhe tarifat e sherbimit si dhe me cilesine dhe vijueshmerine e ketij sherbimi jetik per te gjitha konsumatoret,
- Te nxise konkurrencen,
- Te arrije transparence ne veprimtarine e tij dhe te gjeje nje ekuilibër te drejte ndermjet interesave te konsumatoreve, qeverise, investitoreve dhe te gjitha pjesemarresve te ketij sektori,

**Enti Rregullator i Ujit udhëhiqet nga Komisioni Kombëtar i Rregullimit** i cili per te permbushur detyrat, ne baze te ligjit te mesiperm, ka keto kompetenca te pergjithshme:

- Te jape licenca per entet komerciale qe jane te angazhuara ne kryerjen e sherbimit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te perdorura,
- Te miratoje cimet dhe tarifat e shitjes se ujit, me shumice dhe pakice, tarifat per ujerat e perdorura dhe tarifat e trajtimit te tyre, afatet dhe kushtet e sherbimit te ofruar nga operatorët qe sigurojne uje per konsum publik, edhe ne rastet kur sistemet e ujesjelles-kanalizimeve kane kaluar ne administrim ose pronesi te njesive te qeverisjes vendore,
- Te caktoje standartet per programet e investimeve dhe per shitjen e aseteve nga te licencuarit ne sektorin e ujesjelles kanalizimeve, edhe ne rastet kur keto sisteme kane kaluar ne administrim ose pronesi te njesive te qeverisjes vendore,
- Te krijojë dhe te garantojë zbatimin e standarteve te punes per te licencuarit,
- Te inkurajojë standarte dhe rregulla uniforme per te gjithë sektorin,
- Te pergatise raporte per gjendjen e sektorit per Keshillin e Ministrave dhe te grumbulloje informacionin perkates nga te licencuarit,
- Te caktoje tarifat e aplikueshme per licencat,



- Te vendose sanksione administrative dhe monetare,
- Te nxjerre rregulla per te ndihmuar ne ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve te parashikuara ne kete ligj,

Struktura dhe Organika e ERRU jane te miratuara nga Kuvendi i Shqiperise (Per reference aneksi 1)

## 2.2 Aktivitetet Rregullatore

### *Liçencimi*

Ne sektorin e furnizimit me uje, largimin dhe perpunimin e ujerave te ndotura bazuar ne VKM nr 660 date 12.09.2007, VKM Nr. 81 dt.12.02.2004, VKM Nr. 173 dt. 26.03.2004 dhe VKM Nr. 809 dt. 26.11.2004, gjithsej jane **56 operatore ujesjelles kanalizime** nga te cilat aktualisht:

- |                                               |                                 |
|-----------------------------------------------|---------------------------------|
| • 43 operator jane te liçencuar               | qe mbulojne 88 % te popullsisë, |
| • 5 operator ju ka mbaruar afati i liçencimit | qe mbulojne 5 % te popullsisë,  |
| • 8 operator nuk kane aplikuar asnjehere      | qe mbulojne 7 % te popullsisë.  |

Gjate 2010 kane aplikuar 24 operator ujesjelles kanalizime nga te cilat pas plotesimit te kerkesave ne perputhje me Rregulloren e Liçencimit miratuar me Vendim te KKRRU Nr. 29 date 08.12.2009 kane kaluar per vendimmarrje dhe jane licensuar 19 operatore.

Kane aplikuar **per here te pare** dhe jane liçencuar 7 operator Ujesjelles Kanalizime.

Ju eshte bere **rinovimi i liçencave** per efekt te **ndryshimeve te drejtuesve ligjore apo teknike** 5 operatoreve Ujesjelles Kanalizime.

Si dhe ju eshte bere **rinovimi i liçencave** per efekt **te mbarimit te afatit** 7 operatoreve Ujesjelles Kanalizime.

Nga aplikimet e paraqitura per pajisje me liçence te subjekteve qe kryejne sherbimin e furnizimit me uje dhe largimin e perpunimin e ujerave te ndotura apo vetem njerën prej ketyre sherbimeve jane verejtur keto probleme:


- Operoret Ujesjelles Kanalizime qe veprojnë ne sektor kane veshtiresi ne gjetjen e drejtuesve teknik. Kjo eshte me e theksuar ne rastet e operatoreve qe veprojnë ne zona urbane te vogla me numer klientesh te pakët. Zgjidhja e ketij problemi mund te behet nepermjet nje procesi te studiuar per Rajonalizimin/Agregimin e ketyre operatoreve UK.
- Disa operatore Ujesjelles Kanalizime nuk kane aplikuar asnjehere per tu pajisur me liçence e ushtrimit te veprimtarise konform ligjit, megjithese vlen te theksohet se ky numer sa vjen e behet me i vogel.
- Disa njesi te qeverisjes vendore kane krijuar sektore prane tyre qe operojne ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit te ujrave te ndotura pa marre nje liçence te miratuar nga ERRU dhe ne kundërshtim me Ligjin Nr. 8102 dt.28.03.1996 (i ndryshuar).
- Disa operatore UK kane akoma probleme me kalimin ne pronesi te pushteteve vendore.

- Disa operatore UK kane probleme me regjistrimin ne QKR.
- Operoret UK qe operojne ne zona te vogla urbane kane probleme financiare pasi nuk mbulojne dot as shpenzimet minimale per te plotesuar kushtet e licencimit.
- Problem tjeter ka qene dhe vonesa ne marrjen e deshmive te penalitetit por qe tashme eshte zgjidhur pasi ERRU eshte perfshire ne listen e institucioneve per marrjen online te tyre ne baze te VKM-se Nr. 751 dt. 08.09.2010.

Me poshte eshte paraqitur situata aktuale dhe ecuria ne vite e licencimit te operatoreve Ujesjelles Kanalizime. (Grafiku 1 dhe 2)


**Grafiku 1**

### SITUATA AKTUALE E LICENCIMIT



**Grafiku 2**

### SITUATA E LICENCIMIT NE VITE



## Vendosja e Tarifave

Ne vitin 2010, operatorët që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e perpunimit të ujrave të ndotura paraqiten aplikimet për ndryshimin e tarifave mbështetur në Metodiken “Mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e perpunimit të ujrave të ndotura” (Miratuar me Vendimin e Komisionit Kombëtar të ERRU Nr. 32 datë 21.12.2009).

Gjatë këtij viti kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave 28 operatorë. Komisioni Kombëtar Rregullator ka miratuar ndryshimin e tarifave për 25 prej tyre.



Veçori dalluese në vitin 2010 është numri i lartë i aplikimeve. Gati gjysma e operatorëve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e perpunimit të ujrave të ndotura kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave. Këta operatorë mbulojnë me shërbime rreth 80% të të gjithë popullsisë që përfitojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujrave të ndotura.

Niveli i rregullimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujrave të ndotura brenda kuadrit ligjor është rritur. Për këtë vit, 25% e aplikimeve janë paraqitur nga operatorë që aplikojnë për herë të parë për miratimin e tarifave pranë ERRU si dhe operatorë që nuk kishin aplikuar për ndryshimin e tarifave që nga viti 2003.

Kjo situatë është rezultat jo vetëm i përmirësimeve në metodikë por edhe një bashkëpunimi të suksesshëm me operatorët për rregullimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujrave të ndotura brenda kuadrit ligjor. Rezultat pozitiv në këtë drejtim solli Workshopi me temë “Mbi metodikat e reja të licencimit, tarifave dhe vlerësimit të performancës së Sh.a.UK” organizuar nga ERRU me të gjithë operatorët.

Tarifat kanë patur gjithmone një trendencë rritjeje, por në vitin 2010 ritmi i rritjes së tarifave ka qenë më i lartë se në vitet para-ardhëse. Rritja mesatare e tarifave për shërbimin e ujit për konsum publik është 16%, ndërsa rritja e tarifave për shërbimin e largimit dhe / ose trajtimit të ujrave të ndotura është rreth 33%.

Më poshtë jepet në mënyrë grafike rritja e tarifave të shërbimit për të gjithë konsumatorët gjatë vitit 2010.



Komisioni Kombetar Rregullator, ne vendim-marrjen e tij eshte perpjekur qe tarifat e miratuara jo vetem te mbrojne interesat e konsumatoreve por edhe t'i krijoje operatoreve mundesine te mbulojne kostot e operimit dhe mirembajtjes se sherbimit dhe ne disa raste te mbulojne koston totale kur eshte e mundur, duke synuar uljen e subvencioneve dhe krijimin e mundesive per shlyerjen e kredive.

Ne sektorin e sherbimit te furnizimit me uje jane kryer dhe vazhdojne te kryhen investime kapitale per rehabilitimin dhe zgjerimin e sherbimit te furnizimit me uje, pjesa me e madhe e te cilave jane financiar nga donatore te huaj nepermjet grandeve dhe kredive. Shlyerja e kredive kerkon sigurimin e mjeteve financiare te nevojshme.

Ndertimi dhe venia ne funksionim e impianteve te trajtimit te ujrave te ndotura si dhe rehabilitimi i kolektoreve te largimit te ujrave te ndotura kane sjelle jo vetem permiresimin e ketij sherbimi por dhe nje rritje te konsiderueshme te kostove te operimit dhe mirembajtjes te sistemit te ujrave te ndotura gje e cila eshte reflektuar padyshim edhe ne tarifat e ketij sherbimi.

Ne varesi te performances se operatoreve, nepermjet rritjes se tarifave eshte synuar rritja e shkalles se mbulimit te koston operative dhe koston totale me te ardhurat nga aktiviteti.

Per vitin 2009, mbulimi i koston operative nga te ardhurat nga shitja e sherbimit (per operatoret e analizuar) ka qene 91%, ndersa ne vitin 2010 ky tregues arrin ne 114%.

Mbulimi i koston totale nga te ardhurat nga shitja e sherbimit ne vitin 2009 ka qene 64% dhe ne vitin 2010 arrin ne 80%.

Vendosja e tarifes se shitjes se ujit me shumice si dhe vendosja e tarifes fikse te sherbimit krijuan me shume hapesira per nje bashkepunim me te mire me pushtetet vendore, nje operim me fleksibel per operatorin, nje mundesi tjeter per rritjen e te ardhurave te operatoreve dhe qendrueshmeri per sherbim te vazhdueshem te konsumatori.

ERRU veren se tarifat e reja te aprovuara se bashku me investimet kapitale qe jane kryer dhe po kryhen ne sektor, kane qene nje hap i rendesishem ne ngritjen e qendrueshmerise financiare te operatoreve dhe rrjedhimisht ne rritjen e cilesise dhe sigurise se sherbimit ne drejtim te konsumatoreve dhe zhvillimit te sektorit.

Politika tarifore eshte drejt mbulimit te koston se plote te sherbimit duke ulur njekohesisht masen e subvencionit nga qeveria.

Megjithese tarifat kane ardhur gjithmone ne rritje per mbulimin e kostove totale vazhdon te jete i domosdoshem subvencionimi i disa operatoreve sidomos i atyre qe kane sisteme me stacion pompimi.

Duke patur parasysh politiken e zhvillimit te sektorit por edhe politikat e Qeverise per zhvillimin e vendit, Komisioni Kombetar Rregullator ka synuar rritjen e te ardhurave nga shitja e sherbimit me qellim uljen e mases se subvencionit.

Komisioni Kombetar Rregullator ka qene transparent per te gjitha vendimet e tij si per njesite e qeverisjes vendore, operatoret ashtu edhe per donatore. Komisioni ka bere transparent mendimin e tij perpara çdo vendim-marrjeje si me shkrim ashtu edhe ne takime me te gjitha te

interesuarit. Gjate vitit 2010 u organizuan per here te pare, perpara vendim-marrjes seanca degjimore me palet e interesit.

Ne veçanti nga periudhat para-ardhese, procesi i miratimit te tarifave u krye sipas afateve te percaktuara duke filluar nga paraqitja e aplikimit, shqyrtimi e deri ne vendim-mmarje.

Perjashtimisht per vitin 2010, aplikimet u paraqiten dhe u shqyrtuan ne dy 6 mujor. Per operatoret qe paraqiten aplikimet ne 6 mujorin e pare, aplikimi i tarifave te reja filloi ne 1 Korrik 2010, ndersa per aplikimet e paraqitura ne 6 mujorin e dyte aplikimi i tarifave te reja do te filloje ne vitin 2011.

Shqyrtimi i aplikimeve eshte bazuar ne analizen e treguesve tekniko-ekonomik mbi situaten aktuale dhe ate te projektuar duke evidentuar problemet kryesore per secilin prej tyre, shkaqet dhe mundesite e permiresimit.

Analiza ka konsistuar jo vetem ne krahasimin e te dhenave dhe treguesve te punes mbi bazen e te cileve shoqeria ka parashikuar ndryshimin e tarifave me ato te periudhes para-ardhese, ne raste te veçanta edhe me te dhenat dhe treguesit e punes se dy apo me shume viteve te meparshme, por edhe ne analizen e te gjitha faktoreve qe ndikojne ne ndryshimin e tyre.

Performanca e sherbimeve qe operatoret kryejne eshte analizuar sipas 5 drejtimeve kryesore te percaktuara ne "Planin e veprimit" i cili eshte pjese e dokumentacionit baze te aplikimit. Ai mund te konsiderohet si nje plan afat-shkurter i zhvillimit te aktivitetit te operatorit, pasi hartohet per periudhen ne vazhdim.

Deri tani, tarifat percaktohen me metoden e mbulimit te kostos, bazuar ne parashikimin e treguesve kryesore te performances per vitin ne vazhdim. Operatoreve u lind e drejta te aplikojne per ndryshimin e tyre pas nje viti kalendarik por ato mund t'i perdorin keto tarifa per nje kohe edhe me te gjate.

Metodologjia aktuale per vendosjen e tarifave, megjithe ndryshimet, nuk i pergjigjet situates aktuale te sektorit ku permiresimi i sherbimeve ndaj konsumatoreve kerkon nxitjen e investimeve dhe rritjen e pergjegjesise se operatoreve e ne veçanti edhe te Keshillave Mbikqyres te tyre per arritjen e ketij objekti.

ERRU ka vleresuar si te domosdoshem rishikimin e metodologjise se vendosjes se tarifave per te mbeshtetur operatoret permes nje transparence per konsumatorin duke vendosur stimuj te arritshem dhe sfidues per permiresimin e sherbimit. Per sa me siper, ERRU me mbeshtetjen e GTZ, eshte duke punuar per hartimin e nje metodologjie te re e cila parashikohet te perfundoje brenda gjashtemujorit te pare te vitit 2011.

Nje sistem me transparent i tarifave, vendosja e objektivave konkrete te vleresuara ne kohe mbi bazen e nje planifikimi afat-mesem kerkon nje baze te dhenash ku jo vetem te analizohet ecuria historike e performances per çdo operator, por te sherbeje edhe si baze per percaktimin dhe vleresimin e arritjes se objektivave.

ERRU me mbeshtetjen e GTZ eshte duke punuar ne kete drejtim. Si hap i pare, brenda muajit Maj 2011, do te kemi nje raport te vleresimit te operatoreve per vitin 2010 mbi bazen e treguesve te performances te percaktuar nga ERRU.

Nje objektiv tjetër i ERRU per periudhen ne vazhdim eshte perfshirja ne sistemin tarifar per te gjithë zonat e sherbimit ne vend.

## **Vendosja e Standarteve**

**Ne baze te Ligjit Nr. 8102 (I ndryshuar)**, neni 14, nje nder kompetencat kryesore te Komisionit Kombetar Rregullator eshte krijimi dhe garantimi i standardeve te punes per te licencuarit si dhe inkurajimi i standardeve dhe rregullave uniforme per te gjithë sektorin.

Per sa me siper, Komisioni Kombetar Rregullator ka ndermarre disa iniciativa si me poshte:

- 1) Hartimi i Kontrates Model per sherbimet ne sektorin Ujesjelles Kanalizime ndermjet Konsumatorit dhe Operatoreve te licencuar ne kete sector.

Hartimi i kesaj Kontrate synon rregullimin e aspekteve kryesore te marredhenieve ndermjet konsumatoreve dhe operatoreve te sherbimit, edukimin e paleve per te drejtat dhe detyrat e tyre, evidentimin e pergjegjesive dhe detyrimeve per te dy palet, rritjen e ndergjegjesimit te paleve ne mbrojtjen e mjedisit si dhe parashikimin e trajtimit dhe zgjidhjes se ankesave te konsumatoreve. Aspektet kryesore te kesaj kontrate jane:

- Perkufizimet dhe shpjegimet ne lidhje me sherbimin ne sektorin UK,
- Te drejtat dhe detyrat e konsumatoreve dhe operatoreve te sherbimit,
- Tarifat, pagesat dhe ujematesit,
- Cilesia e ujit dhe mbrojtja e mjedisit,
- Kundervajtjet e paleve, ndryshimet, pezullimi dhe zgjidhja e kontrates.

Kjo iniciative eshte ndermarre nga ERRU ne bashkepunim me METE dhe me mbeshtetjen e UNDP. Zbatimi i Projektit per hartimin e kesaj Kontrate filloi ne Tetor te vitit 2010, ne baze te termave te references te hartuara nga ekspertet e UNDP dhe te miratuara nga Komisioni Kombetar Rregullator. Ne fund te vitit 2010, konsulentet ligjore te perzgjedhur per kete projekt perfunduan draft kontraten, e cila pas konsultimeve te hapura me aktoret kryesore te sektorit do te aprovohet nga Komisioni Kombetar Rregullator. Kontrata model e aprovuar do te zbatohet nga te gjithë operatorët e licencuar brenda vitit 2011.

- 2) Pergatitja e Manualit per Anetaret e Keshillave Mbikqyres ne lidhje me sherbimet e sektorit Ujesjelles-Kanalizime.

Pergatitja e ketij Manuali dhe Guides perkatese synon jo vetem permiresimin e performances se tyre por percakton edhe bazen ligjore te veprimtarise se Keshillave Mbikqyres, rolin e tyre ne monitorimin e performances se sherbimit UK si dhe te emerimit apo caktimit te drejtuesve ligjore per ofruesit e sherbimit, etj.

- 3) Zbatimi i Rregullores per furnizimin me uje dhe kanalizime ne zonen e sherbimit te Operatoreve (Kodi i Ujit).

Kodi i Ujit eshte aprovuar me VKM Nr.1304, dt.11.12.2009. Objektivat kryesore te ketij Kodi jane:

- Percaktimi i Rregullave dhe Kerkesave qe duhet te permbushin Operatorët e Sherbimit per nje sherbim sasior dhe cilesor ne sektorin UK.
- Krijimi i nje marredhenie te re ligjore ndermjet Pronareve te Aseteve (njesive te qeverisjes vendore) dhe Administratoreve te ketyre asetëve.

Ne baze te VKM se mesiperme, ERRU dhe DPUK jane institucionet pergjegjes per zbatimin e ketij Kodi. Ne fund te muajit Dhjetor 2009, Komisioni Kombetar Rregullator nxorri Vendimin e tij perkates ne lidhje me aprovimin dhe zbatimin e kesaj rregulloreje nga Operatoret e sherbimit si dhe njesite e qeverisjes vendore te cilat jane pronare te aseteteve te ketyre sistemeve. Gjithashtu, ERRU ne bashkepunim me shoqaten SHUKALB ka shperndare kete rregullore te aprovuar tek te gjithë operatorët e sherbimit ne kete sektor dhe kane organizuar konferenca dhe seminare per sqarimet ne lidhje me kete Kod dhe menytrat e zbatimit te tij ne praktike.

Qe nga muaji Janar 2010, ERRU ka dhene licenca dhe ka aprovuar tarifa te reja vetem per operatoret qe e kane firmosur Kodin e Ujit. Deri me sot, 28 operatore te sherbimit, qe veprojne ne afro 80 % te zonave urbane, e kane firmosur dhe po e zbatojne kete Rregullore.

#### 4) Bashkepunimi me Institutin e Shendetit Publik ne lidhje me cilesine e Ujit.

Duke e pare çeshtjen e cilesise se ujit si nje tregues mjaft te rendesishem te sherbimit ne kete sektor si dhe tregues te nevojshem per analizen e performances se operatoreve te sherbimit, ERRU ndermorri iniciativen per te krijuar marredhenie bashkepunimi me Institutin e Shendetit Publik (ISHP) i cili eshte institucioni pergjegjes per monitorimin dhe kontrollin e cilesise se ujit per konsum publik. ERRU gjeti perkrahjen e plote nga ISHP per nenshkrimin e kesaj marreveshje dhe shkembimin e te dhenave ne lidhje me kete tregues te sherbimit.

#### 5) Bashkepunimi me Ministrine e Mjedisit per çeshtjet e mbrojtjes se burimeve ujore dhe Mjedisit.

Nje çeshtje mjaft e rendesishme qe lidhet me sherbimin ne kete sektor eshte edhe mbrojtja e burimeve ujore si dhe mbrojtja e mjedisit nga shkarkimet e ujrave te ndotura ne basenet ujore te vendit. Per keto arsye, ERRU ndermorri iniciativen per nenshkrimin e marrevshjes se bashkepunimit me Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave qe eshte edhe institucioni pergjegjes per monitorimin dhe kontrollin e burimeve ujore si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe te baseneve ujore siperfaqesore. ERRU gjeti perkrahjen e plote nga kjo Ministri per nenshkrimin e kesaj marreveshje.

## Analiza e Sektorit

Komisioni Kombetar Rregullator me Vendim Nr.38, date 23.07.2010 per “Miratimin e Tregueseve Kryesore te Performances (TKP) dhe peshes se tyre”, ka marre ne shqyrtim dhe ka vendosur Treguesit Kryesore te Performances se Operatoreve te sherbimit UK dhe peshat respektive te tyre.

**Tabela 1.** Treguesit Kryesore te Performances (TKP)

| Nr. | Indikatoret Kryesore te Performances  | Pesha |
|-----|---------------------------------------|-------|
| 1   | Mbulimi Kostos Totale                 | 10    |
| 2   | Mbulimi Kostos Operim & Mirembajtjes  | 10    |
| 3   | Sasia e Ujit te Matur                 | 15    |
| 4   | Niveli i Arketimit                    | 18    |
| 5   | Ecuria e Furnizimit me Uje (ne ore)   | 10    |
| 6   | Cilesia e ujit te Pijshem             | 15    |
| 7   | Eficienca e Stafit (Staf/1000 lidhje) | 5     |
| 8   | Mbrojtja e Mjedisit                   | 5     |
| 8   | Humbjet e Ujit                        | 8     |
| 10  | Perceptimi Rregullator                | 2     |
| 11  | Zona e mbulimit me Kanalizime         | 2     |

Burimi: ERRU

Mbi bazen e TKP mundesohet nje vleresim i performances se Sektorit UK, duke konkluduar ne faktin sesi ka performuar Sektori lidhur me keta tregues.

Performanca individuale e Operatoreve te sherbimit UK bazuar mbi keta Tregues do te paraqese nje vleresim me real dhe adekuat te ecurise tekniko-ekonomike te tyre.

Ne zbatim te detyrave te tij, ERRU do te prezantoje Benchmarking, ku te gjithe Operoret e Sherbimit UK renditen sipas ecurise se TKP, ne forme te nje Operatori sherbimi te “mire” dhe “te keqe”, duke evidentuar per marrje shembulli Operoret me ecurine me te mire.

TKP do te perbenin nje nga shtyllat kryesore te vleresimit gjate procesit te Vendosjes se Tarifave nga ERRU.

ERRU, ne kuader te aplikimit te Benchmarking dhe aspekteve te tjera qe lidhen me trajtimin e TKP, ka nisur nga puna dhe aktualisht eshte nen proces te krijimit te te dhenave respektive qe duhet te trajtohen per keto ceshtje. Zhvillimi i ketij procesi synon drejt mbledhjes se te dhenave sa me reale, cilesore dhe ne kohen e duhur, te marra drejt per drejti nga Operoret apo Institucionet pergjegjese. Ne kete aspekt, nje rendesi te vecante paraqet bashkepunimi me Njesine e Monitorimit prane DPUK, e cila aktualisht ka te ndertuar nje sistem te dhenash mbi aktivitetin e Operatoreve te sherbimit UK si dhe te Sektorit.

Nje rendesi te madhe do te kete pjesmarrja e Institucioneve te tjera pergjegjese qe veprojne ne sektorin UK. ERRU ka marreveshje bashkepunimi me keto institucione, ku nder ceshtjet e tjera te bashkepunimit perfshihen edhe shkembimi i te dhenave apo informacioneve reciproke, te cilat do te perbenin nje baze te mire te te dhenave te sakta dhe cilesore per disa TKP.



Ne baze te Ligjit Nr.8102, dt.28.03.1996, i ndryshuar, Neni 14, pika "f", si dhe Neni 31, pika (1) a), KKRR pergatit me shume seriozitet dhe ne menyre sa me profesionale Raporte per gjendjen e Sektorit, nepermjet mbledhjes se informacionit nga te licencuarit. Ne funksion te detyrave te tij ligjore, ERRU vijon te jape kontributin e tij si nje Rregullator mbi zhvillimet dhe sfidat e Sektorit UK.

ERRU merr ne konsiderate procesin qe po zhvillohet ne lidhje me Strategjine Kombetare qe ne te vertete mbetet nje nga sfidat me te rendesishme te Sektorit te UK. Vlen te permendet kontributi i ERRU me komentet e tij per te gjitha ceshtjet qe perbejne sferen e ushtrimit te aktivitetit te ketij Institucioni ne kete Sektor, per strategjine qe duhet te ndiqet.

Zhvillimet e deri tanishme qe po ndodhin ne Sektor lidhur me ndertimin dhe venien ne funksionim te Impianteve te Trajtitit te Ujave te Ndotura perbejne nje zhvillim te konsiderueshem, nderkohe qe mbetet shume per te bere lidhur me menaxhimin e tyre.

ERRU si nje Institucion i pavaruar ka luajtur dhe vazhdon me tendence rritje te luaje rolin e saj te percaktuar me ligj, ne sektorin e UK si nje ze i pavaruar, si nje nga aktoret kryesor te tij, nepermjet ushtrimit te aktivitetit te tij ne aspekt te procesit rregullator ne sektor.

Analiza e sektorit UK nepermjet TKP te percaktuara tashme, sipas nje sistemi te dhenash qe pritet te perfundoje se shpejti nga ERRU, te mbledhura nga operatoret dhe Institucione te tjera qe bashkeveprojne me kete sektor, jane drejtime te punes se ketij Institucioni per vitin 2011 ne kuader te analizes dhe komenteve te sektorit.

ERRU planifikoi dhe nisi nga puna ne vitin 2010, duke vijuar aktualisht me tej me procesin e Rishikimit dhe Implementimit te Tarifave se Re te Metodologjise se Vendosjes se Tarifave, e cila do te hyje ne fuqi brenda ketij viti dhe do te perbeje nje kontribut shume te madh ne performancen e Shoqerive te UK.

Hartimi dhe Implementimi i Standarteve per Marredhenien me Konsumatorin, hartimi dhe Implementimi i Rregullores per Mbarevajtjen e punes te Keshillave Mbikqyres, hartimi dhe Implementimi i Standarteve Minimale te Sherbimit do te gjejne konkretizim brenda vitit 2011.

Ne te njejten linje per vitin 2011 mbetet edhe puna e ERRU ne vijim te procesit tashme te nisur lidhur me Rregullimin e Ofrueseve te Sherbimit UK ne Zonat rurale.

Te gjitha sa me siper, perbejne pa dyshim ate impakt shume te rendesishem qe jep ky Institucion ne performancen e Sektorit UK.

### **2.3 Perfshirja e Konsumatorit dhe transparenca gjate procesit rregullator**

ERRU gjate veprimtarise se tij ka patur ne konsiderate nje nder detyrat kryesore te tij per mbrojtjen e Konsumatoreve ne lidhje me cilesine e sherbimit, tarifat dhe kushtet e tjera te ketij sherbimi ne sektorin UK. Ndryshimi i tarifave eshte bere vetem ne baze te analizes se permiresimit te treguesve te performances nga ana e operatorëve si dhe mbrojtjen e konsumatoreve shqiptare. Keto ndryshime nuk kane qene te menjehershme por jane bere ne baze te nje procesi te kujdesshem rregullator dhe transparent.

Mbrojtja e Konsumatorit eshte bere jo vetem nepermjet ndryshimit te tarifave bazuar ne treguesit e mesiper por edhe nepermjet perfshirjes se tyre ne kete proces, rritjes se

kontakteve direkt me konsumatorët për cilësinë e shërbimit apo tarifave të këtij shërbimi, rritjes së transparencës gjatë procesit të vendosjes së tarifave, etj.

Të gjitha vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator dhe aktiviteti i tij, është pasqyruar në mënyrë të vazhdueshme në faqen e internetit të institucionit [www.erru.al](http://www.erru.al) si dhe në mediat lokale dhe kombëtare.

ERRU në synimet e tij, po kërkon të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit. Gjatë vitit 2010, ERRU me mbështetjen e UNDP ka iniciuar fillimin e një procesi studimor për cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe përgatitjen e standarteve të shërbimit për të gjithë operatorët në Shqipëri. Janë përgatitur “Termat e References” për këtë projekt dhe ka filluar faza e përzgjedhjes së konsulentëve përkatës. Ky proces do të konsistoje:

- në identifikimin e operatorëve që ofrojnë një shërbim ndaj konsumatorit,
- në analizen e cilësive të këtij shërbimi duke e krahasuar me eksperiencat europiane,
- në zhvillimin e një grupi standartesh dhe një metodologjie të caktuar për shërbimin ndaj konsumatorit nga operatorët e sektorit UK,
- në formulimin e rekomandimeve për hapat që duhet të ndermerren në futjen e këtij modeli tek operatorët e sektorit UK (përgatitja e rregulloreve, struktura, mjetet e komunikimit, stafi i nevojshëm, etj).

## 2.4 Aktivitetet për konsolidimin Institucional

Gjatë vitit 2010, ERRU ka ndermarre një sërë iniciativash për konsolidimin institucional të tij. Viti 2010 ka qenë një vit i ngarkuar me punë për trajtimin e disa çështjeve themelore të aktivitetit të institucionit siç janë:

- Përcaktimi i Treguesve për vlerësimin e performancës së operatorëve.
- Përpunimi i metodikës së re të vendosjes së tarifave.
- Përpunimi i një strukture të qëndrueshme për raportin vjetor të aktivitetit të ERRU.
- Përgatitja e standarteve uniforme të shërbimit dhe rritja e transparencës në komunikimin ndërmjet Operatorëve dhe Konsumatorëve.

Grupe të ndryshme pune janë ngritur dhe kanë trajtuar këto çështje duke dhënë kontributin e tyre në bashkëpunim me konsulentin e GTZ.

Aktivitetet për konsolidimin institucional të ERRU janë organizuar në tre drejtime kryesore:

- Përmes trajnimeve të stafit dhe antareve të KKRR, në bashkëpunim me konsulentët e GTZ, në lidhje me teorinë dhe praktikën për çështjet rregullatore, Metodikën e vendosjes së tarifave apo përcaktimin e Treguesve Kryesore të Performancës.
- Përmes pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit.
- Përmes shkëmbimit të eksperiencave me Entë Rregullatore analoge në Europë.

Nder aktivitetet kryesore gjate vitit 2010 mund te permenden:

- Trajnimet prane zyrave te ERRU nga konsulentet e GTZ per metodiken e vendosjes se tarifave, treguesit kryesore te performances, etj.
- Pjesamarrja e nje ekipi te ERRU ne nje vizite studimore prane OFWAT, UK, e organizuar nga Konsulentet e GTZ, per tu njohur me eksperiencat e nje prej rregullatoreve me te fuqishem dhe tradicionale te sektorit te ujit. Gjate kesaj vizite u zhvilluan diskutime dhe analiza jo vetem per çështjet rregullatore ne sektor por edhe per çështje te tjera te rendesishme si mbrojtja e mjedisit, perfshirja e konsumatoreve, marredheniet ndermjet Enteve Rregullatore dhe Operatoreve, etj. Birmingham dhe Londer, UK, Maj 2010.
- Trajnimi i eksperteve te ERRU per Menaxhimin e Sistemeve te Ujrave Urbane, Sapporo, Japoni, Korrik 2010.
- Pjesmarrja e nje ekipi te ERRU ne seminarin e organizuar nga ADA dhe Ballkan NET per Permiresimin e kapaciteteve te Operatoreve te sektorit te Ujit ne Shqiperi dhe Maqedoni, Oher, Maqedoni, Shtator 2010.
- Pjesmarrja e dy antareve te KKRR ne kursin e shkurter te trajnimit te organizuar nga Shkolla Londineze e Shkencave Ekonomike dhe Politike (LSE) ne lidhje me teorine, strategjine dhe praktikat mbi Çështjet Rregullatore, Londer, UK, Shtator 2010.
- Pjesemarrja e dy anetareve te KKRR ne konferencen nderkombetare per Ujin dhe Energjine ku u trajtuan çështje ne lidhje me menytrat e vleresimit dhe rregullimit te sektorit si dhe konceptet e reja per trajtimin dhe menaxhimin e ujrave te perdorura kundrejt efikasitetit te energjise, Amsterdam, Hollande, Nentor 2010.
- Pjesmarrja e nje ekipi te KKRR ne takimet me perfagesues te Komisionit Kombetar te Ujit te Izraelit ku u diskutuan çështjet ne lidhje me metodiken e vendosjes se tarifave te ujit si dhe çkripezimi i ujit te detit dhe riperdorimi i tyre.

## 2.5 Marredheniet e jashtme

### ***Bashkepunimi me Institucionet ne Shqiperi***

ERRU duke iu permbajtur edhe objektivate strategjike te Qeverise per te mundesuar efektivitetin e sherbimeve te ujesjelles kanalizimeve per permiresimin e performances se sektorit dhe mbrojtjes se konsumatorit, si dhe synimeve te saj per bashkepunim me te gjitha palet e interesit, ka si qellim bashkepunimin me institucionet e meposhtme:

- Kuvendi i Shqiperise
- Keshilli i Ministrave
- Ministria e Puneve Publike dhe Transportit
- Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes (METE)
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave

- Shoqata e Ujesjelles Kanalizimeve e Shqiperise (SHUKALB)
- Instituti i Shendetit Publik (ISHP)
- Autoriteti i Konkurences

### ***Bashkepunimi me Donatoret e Huaj ne Shqiperi***

ERRU ka patur nje bashkepunim shume te mire me donatoret e huaj si me poshte:

- Bashkepunimi me Qeverine Gjermane permes projektit te financuar nga **GTZ** i cili ka filluar qe prej vitit 2009. Ne kuader te kesaj marreveshje, GTZ ka dhene ndihmesen e tij per sa i perket: **a) Forcimit Institucional, b) Permiresimit te Metodologjise se Tarifave, c) Treguesit e Performances, d) Permiresimit te Raportit Vjetor** si dhe jane organizuar nje sere Workshop-esh, Konferenca dhe eshte bashkepunuar ne shume drejtime te tjera nga ku si rrjedhoje po shqyrtohet edhe ideja per zgjerimin e projektit.
- **Bashkepunimi me UNDP** ka qene shume frytdhenes per vendosjen e disa standarteve ne kete sektor siç jane:
  - Pergatitja e Kontrates model ndermjet Operatoreve dhe Konsumatoreve.
  - Hartimi dhe Implementimi i standarteve per sherbimin ndaj Klientit.
- **Bashkepunimi i frytshem me USAID.** Programi i Qeverisjes Vendore ne Shqiperi i USAID eshte krijuar per te ofruar trajnim dhe asistence teknike, per te aftesuar disa njesi te qeverisjes vendore te perzgjedhura per rritjen e zhvillimit ekonomik lokal. Ne kuader te kesaj nisme eshte duke u punuar nga te dy palet edhe per trajnimin e Keshillave Mbikqyres.

### ***Bashkepunimi i ERRU me Rregullatoret Nderkombetar***

- **ERRU – ERSAR / Portugali**  
Ne kuader te marreveshjes se bashkepunimit midis ERSAR dhe ERRU si dhe ne baze te fteses se perbashket te ERRU dhe SHUKALB, gjate konferences vjetore te Ujit te zhvilluar jave e pare te muajit Nentor 2010, u prezantua nga perfaqesuesi i ketij institucioni tema “Aspekte Rregullatore per menaxhimin e sistemeve ujore ne zonat rurale te Portugalise”, e lidhur ngushte me temen e konferences se ujit te ketij viti. Gjithashtu gjate kesaj periudhe u organizua nje takim i perbashket ndermjet perfaqesuesve te ERRU, ERSAR dhe ZRRUM si dhe konsulentëve te GTZ ku u diskutua per çështjet rregullatore ne vendet perkatese si dhe per zgjerimin e kontakteve dhe bashkepunimit ndermjet Enteve Rregullatore ne Europe.
- **ERRU – ZRRUM / Kosove**  
Edhe per vitin 2010 ERRU – ZRRUM zhvilluan workshop-in e pervitshem ne qytetin e Vlores bazuar ne marreveshjen e bashkepunimit midis dy institucioneve me qellim kryesor shkembimin e eksperiencave rregullatore. Temat rreth te cilave u fokusua ky workshop ishin mbi legjislacionin, tarifat dhe analizen e treguesve te performances.

- **ERRU – KOMISIONI KOMBETAR PER ÇMIMET DHE ENERGJINE / Lituani**

Marreveshja e bashkepunimit e nenshkruar midis Rregullatorit te Lituane dhe ERRU ka qene nje tjeter hap i rendesishem per bashkepunimin dhe bashkeveprimin me institucione analoge ne Evrope si dhe rasti i veçante i nje rregullatori multisektorial.

- **ERRU – KOMISIONI KOMBETAR I UJIT / Izrael**

Vizita e punes e zhvilluar prane Komisionit Kombetar te Ujit te Izraelit kishte si qellim shkembimin e eksperiencave midis dy Institucioneve tona. Çeshtjet si: Metodologjia e vendosjes se tarifave, Standartet e sherbimit ne sektorin UK, Liçencimi i operatoreve UK etj, ishin ne fokus te takimeve te zhvilluara me homologet izraelit. Pjese e programit te takimeve ishte vizita prane Impiantit te Shkripezimit te ujit te detit ne Ashkelon.

### ***Takime pune dhe konferenca***

- **Aktivite te organizuara nga ERRU**

- Per te paren here ne muajin Prill 2010, ERRU organizoi nje workshop me te gjithë operatorët që ushtrojnë aktivitetin e tyre ne sektorin UK per te prezantuar procedurat e reja te dhenies se liçencave dhe te miratimit te tarifave. Ky workshop pati nje rendesi mjaft te madhe per bashkerendimin e punes midis ERRU dhe operatoreve.
- Workshopi i radhes u zhvillua ne muajin Shtator me te gjithë aktoret ne sektorin UK dhe donatorët, me tematike "Roli i Entit Rregullator te Ujit ne Sektorin e Furnizimit me Uje dhe Largimit dhe Perpunimit te Ujërave te Ndotura – Misioni dhe Sfidat"

- **Pjesemarrja e ERRU ne aktivitetet e Sektorit UK**

- Ne kuader te aktiviteve te zhvilluara nga MPPT per draft Strategjine e Ujit, ERRU jo vetem ka marr pjese ne grupe pune per formulimin e strategjise por ka qene pjese aktive ne panele diskutimesh me sygjerimet e tij draft strategjine.
- Kontributi i ERRU si nje aktor i rendesishem Rregullator ka qene gjithashtu i vlefshem ne aktivitetet e tjera te zhvilluara nga Ministria e Puneve Publike dhe e Transportit per sa i perket temes "Mekanizmat Financiare dhe Masterplani". Ky kontribut ka dal ne pah edhe ne workshopin per rajonalizimin e sektorit UK.
- Ne konferencen e Ujit qe u zhvillua ne muajin Nentor te ketij viti ERRU kishte nje sesion te veçante ne lidhje me Rregullatorin ne teresi dhe legjislacionin e tij. Ky sesion theksoi rendesine e rregullatorit ne lidhje me temen "Sigurimi i Sherbimit per Zonat Rurale dhe te Varferit" nje teme mjaft e ndjeshme per sektorin.

- **Marredheniet e ERRU me Median**

Marredheniet me mediat luajne nje rol te rendesishem ne shume drejtime dhe ne kete kontekst ERRU gjate vitit 2010 eshte angazhuar nepermjet formave te ndryshme te ndikoje ne informimin e institucioneve dhe publikut te gjere. Aktivitetet konkrete qe ka zhvilluar ERRU ne kontekstin e marredhenieve me publikun pershkruhen me poshte:

- Kryetari i Komisionit Kombetar Rregullator ka patur disa prezantime ne televizione e media te ndryshme ku ka folur mbi synimet dhe zhvillimet ne sektorin e ujesjelles kanalizimeve.
- Intervista dhe informim i publikut permes Televizionit Ora News dhe Vision PLUS ne lidhje me procesin e ndryshimit te tarifave te sherbimit per furnizimin me uje dhe largimin e ujrave te ndotura te ofruesit me te madh te sherbimit ne vendin tone, Sha UK Tirane.
- Eshte zhvilluar nje konference per shtyp me perfaqesues te Ministrise se Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes (METE) per sa i perket draft-kontrates tip ndermjet konsumatoreve dhe operatoreve qe ushtrojne aktivitet ne sektorin e ujesjelles kanalizimeve.
- Ne muajin Dhjetor 2010, Kryetari i Komisionit Kombetar Rregullator ka qene i ftuar ne Top Channel ne emisionin Top Show me teme "Beteja per Ujin".
- Ne kete kontekst, jane bere edhe disa botime ne media te ndryshem lidhur me aktivitetin e ERRU.

## 2.6 Te Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU

### Te ardhurat


ERRU eshte institucion i pavarur qe nuk financohet nga buxheti i shtetit, por me te ardhurat qe krijon nga veprimtaria e tij. Sikurse percaktohet ne Nenin 10 te Ligjit Nr. 8102, date 28.03.1990 “Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujerave te ndotura”, operacionet e ERRU financohen nga pagesat per licencimet, pagesat rregullatore te operatoreve qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne sektor dhe donatoret. Pavaresisht kesaj, fondi vjetor i shpenzimeve te ERRU miratohet çdo vit nga Keshilli i Ministrave.

Obligimi ligjor per te perballuar te gjitha shpenzimet nga te ardhurat e realizuara, kushtezon ERRU, pasi jo vetem qe duhet te siguroje vete mbeshtetjen financiare per ushtimin e aktivitetit dhe permbushjen e misionit te tij, por duhet te monitoroje ne vazhdimesi perdorimin e fondeve ne raport me te ardhurat e realizuara.

Te ardhurat totale te realizuara per vitin 2010 jane ne shumen **41 806 334 leke**, nga te cilat **40 891 500 leke** jane nga pagesat rregullatore, duke zene keshtu 97.8% te totalit te te ardhurave te realizuara.

Struktura e te ardhurave vjetore te realizuara per vitin 2010 paraqitet ne grafikun e meposhtem.

**Grafiku 5** Te ardhurat vjetore te realizuara



Te ardhurat e realizuara gjate ketij viti jane me te lartat te realizuara deri me sot nga ERRU. Ato mbulojne plotesisht fondin vjetor te shpenzimeve operative te ERRU per vitin 2011, duke mundesuar edhe derdhjen e tepriceve ne buxhetin e shtetit ne vitin 2011.

Duke analizuar shlyerjen e detyrimeve te pagesave rregullatore gjate vitit, konstatojme se nga **40 891 500 leke** te arketuara, **25 856 500 leke** jane detyrime te vitit 2010, dhe **15 026 000 leke** jane detyrime per llogari te viteve te mepareshme.

Pavaresisht nga sa me siper, ne mbyllje te vitit rezulton se operatoret nuk kane shlyer nga detyrimet e konstatuara per pagesat rregullatore ndaj ERRU, sipas kontratave ne shumen **15 011 000 leke**.

### Shpenzimet operative

Ne zbatim te Nenit 11, te Ligjit Nr. 8102, date 28.03.1996, “ Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujerave te ndotura”, plani vjetor i shpenzimeve operative te ERRU, per vitin 2010 eshte miratuar me VKM Nr. 1061, date 21.10.2009, “Per

miratimin e fondit te shpenzimeve, per vitin 2010, te Entit Rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura”.

Ne total fondi vjetor i shpenzimeve operative te ERRU per vitin 2010 eshte ne shumen **30 000 000 leke** dhe i detajuar ne zera si me poshte:

- |                        |                 |
|------------------------|-----------------|
| • Paga dhe shperblime  | 18 241 000 leke |
| • Sigurime shoqerore   | 2 869 000 leke  |
| • Sherbime e furniture | 5 300 000 leke  |
| • Investime            | 3 590 000 leke  |

Shpenzimet buxhetore te kryera per ushtrimin e aktivitetit dhe veprimtarise vjetore te Entit per vitin 2010 jane ne shumen **26 055 450 leke**, ose 86.85% e fondit te miratuar nga Keshilli i Ministrave.

Nga struktura e shpenzimeve konstatojme se:

- 18 918 000 leke, ose 72.6% te shpenzimeve, jane shpenzimet e kryera per paga e sigurime shoqerore e shendetsore.
- 5 050 800 leke, ose 19.4% te shpenzimeve jane shpenzimet e kryera per sherbime e furniture
- 2 086 700 leke, ose 8% te shpenzimeve, jane shpenzime per investime.

Perdorimi i fondeve te planifikuara, eshte bere ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore ne fuqi si per trajtimin me paga e shperblime te te punesuarve ashtu dhe per blerjet e mallrave e sherbimeve te ndryshme ne perputhje e ne zbatim te ligjit “Per prokurimet publike”.

### 3. Gjendja e Sektorit Ujesjelles – Kanalizime

Ne sektorin e sherbimeve te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura, ofrojne sherbimin 56 operatore, nga te cilet vetem 28 kryejne te dy sherbimet. Me gjithë permiresimet e vazhdueshme, sektori vazhdon te kete probleme, pasi keto sherbime nuk i ofrohen gjithë popullsise ne zonen e sherbimit si per arsye teknike ashtu dhe te nje menaxhimi jo te mire te zones se sherbimit.

Konkretisht, operatorët mbulojnë me sherbimin e furnizimit me uje rreth 87% te popullsise ne zonen e juridiksionit dhe me sherbimin e largimit te ujrave te ndotura rreth 67% te saj.

Gjithashtu furnizimi me uje dhe grumbullimi dhe largimi i ujrave te ndotura ne shume komuna e bashki administrohet nga sektore qe veprojnë brenda njesive te qeverisjes vendore dhe qe nuk jane te licencuar nga ERRU sipas ligjit ne fuqi. Kjo ndikon jo vetem ne mos menaxhim te mire te ketyre sistemeve por edhe ne uljen e cilesise se sherbimeve.

Sasia e ujit te prodhuar mbulon kerkesen per uje. Aktualisht 47% e ujit prodhohet nga sistemet e kombinuara me rrjedhje te lire dhe ngritje mekanike, 44% nga sistemet me ngritje mekanike dhe 9% nga sistemet me rrjedhje te lire.

Sherbimi i kanalizimeve per shumicen e operatoreve nenkupton grumbullimin dhe largimin e ujrave te ndotura dhe i ofrohet kryesisht klienteve ne zonat urbane.



Aktualisht trajtimi i ujrave te ndotura kryhet vetem nga dy operatore.

Analiza e disa treguesve kryesor te performances se sektorit UK dhene ne tabelen e meposhtme te cilat jane analizuar nga ERRU, pasqyron gjendjen ne sektorin ujesjelles kanalizime.

**Tabela 2** Trendi i treguesve te performances

| Treguesit e Performances                            | 2009   | 2010   | Trendenca |
|-----------------------------------------------------|--------|--------|-----------|
| 1- Mbulimi i K.T.O me te ardhurat nga faturimi      | 39.5 % | 56.0 % | ↗         |
| 2- Mbulimi i Kostos O&M me te ardhurat nga faturimi | 54.0 % | 78.0 % | ↗         |
| 3- Furnizimi me uje (ore/dite)                      | 14     | 14     | =         |
| 4- Uji i Pafaturuar                                 | 70.0 % | 60.0 % | ↗         |
| 5- Sasia e Ujit te matur                            | 41.0 % | 45.0 % | ↗         |
| 6- Niveli i Arketimeve                              | 74.8 % | 76 %   | ↗         |
| 7- Efienca e stafit (Staf/1000 lidhje)              | 13.6   | 13.6   | =         |
| 8- Mbulimi i zones se sherbimit me KUN              | 62 %   | 67.0 % | ↗         |

\*Koment.

### **Cilesia e sherbimit ne sektor**

ERRU e konsideron cilesine e sherbimit te furnizimit me uje te konsumatoreve si nje tregues te rendesishem te performances se operatoreve. Gjate vitit 2010 ky tregues eshte vleresuar dhe monitoruar ne drejtim te vazhdimesise se sherbimit, nderprerjeve te planifikuara dhe te paplanifikuara te ujit, demtimeve ne rrjet, si dhe cilesise se ujit te pijshem .

Vazhdimesia e sherbimit ne sektor ne vitin 2010 nuk ka patur ndonje ndryshim te dukshem krahasuar me vitin 2009. Duke ju referuar te dhenave te Njesise se Monitorimit dhe Benchmarkit prane DPUK, per te dy vitet shkalla e furnizimit me uje varion nga 4 deri ne 24 ore uje ne dite. Shumica e operatoreve, rreth 45% prej tyre, kryejne furnizimin me uje sipas nje grafiku te percaktuar. Oret e furnizimit me uje variojne nga 8-20 ore ne dite. Per nje pjese jo te pakonsiderueshme, rreth 39% e operatoreve, vazhdimesia e furnizimit me uje le per te deshruar. Ky sherbim ju ofrohet konsumatoreve nga 4-8 ore ne dite. Por, ka edhe operatore qe ofrojne furnizim 24 ore me uje te pijshem dhe me presionin e duhur.

Gjithashtu numri i nderprerjeve te paplanifikuara dhe demtimeve ne rrjet eshte i larte, gje qe tregon se per konsumatorët pavaresisht nga arsyt, cilesia e sherbimit te furnizimit me uje eshte ne nivele jo te kenaqshme. Ne te gjitha sistemet e furnizimit me uje behet dezinfektimi i ujit te pijshem. Kontrolli i cilesise se ujit behet kryesisht nga Instituti i Shendetit Publik i cili gjate te gjithë vitit 2010 ka nje monitorim te perditeshem te te dhenave te cilesise se ujit per konsum publik ne te gjitha zonat urbane te vendit.

*\*Treguesit e mesiperm jane llogaritur duke ju referuar te dhenave te Njesise se Monitorimit per vitin 2009 dhe 6/mujorin e pare te vitit 2010 si dhe Metodologjise se ERRU-se "Mbi vendosjen e tarifave te sherbimit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura".*

Cilesia e sherbimit te grumbullimit dhe largimit te ujrave te ndotura vazhdon te jete e dobet, bllokimet e ketyre sistemeve si dhe vonesat ne riparimin e difekteve te konstatuara krijojne probleme per konsumatore.

Gjithashtu shkarkimi i ujrave te ndotura nga keto sisteme ne basenet ujore pa u trajtuar krijon probleme mjedisore ne zonen e shkarkimit. Aktualisht jane vetem 2 impiante te trajtimit te ujrave te ndotura (Pogradec dhe Kavaje) me kapacitet total 50 000 p.e qe funksionojne rregullisht. Jane ne ndertim edhe 5 impiante te tjera trajtimi te cilat do te perfundojne gjate vitit 2011.

### ***Uji i pafaturuar***

Niveli i larte i humbjeve mbetet nje prej drejtimeve me problematike te performances se operatoreve qe kryejne sherbimin e furnizimit me uje. Ne vitin 2010, niveli mesatar i humbjeve rezulton te jete rreth 60%.

Duhet theksuar se ne vitin 2010 ka patur zhvillim pozitiv ne kete drejtim. Disa prej operatoreve e kane patur prioritet te punes se tyre zvogelimit e humbjeve dhe kane arritur rezultate pozitive. Kjo gje eshte reflektuar ne permiresimin e ketij treguesi ne sektor. Ne vitin 2010 krahasuar me vitin 2009 niveli mesatar i humbjeve ne sektorin e furnizimit me uje eshte ulur rreth 12%.

Pra, sasia e ujit qe perdoret eshte me e vogel se ajo qe per shkaqe te ndryshme siç jane humbjet nga demtimet ne rrjet, mungesa e matesave apo lidhjet ilegale nuk arrin tek perdoruesit.


Niveli i larte i humbjeve cenon qendrueshmerine financiare te operatoreve. Per shkak te nivelit te larte te tyre operatorët kryejne me shume shpenzime per prodhimin dhe shperndarjen e ujit se sa eshte nevoja per uje, e nga ana tjeter uji i pafaturuar nuk sjell te ardhura.

ERRU e ka vleresuar reduktimin e humbjeve si prioritet kryesor te punes se operatoreve duke kerkuar ne menyre te vazhdueshme qe ta kene ne vemendje e te marrin te gjitha masat e mundshme per reduktimin e tyre .

Tendenca e ketij treguesi eshte ne ulje, çka flet per nje trend pozitiv. Grafiku i meposhtem flet qarte per tendencen e ketij treguesi.

**Grafiku 6**


Tendenca e humbjeve ne vite.



*Burimi:* ERRU, mbështetur ne dhe te dhenat e Njesise se Monitorimit per 6 mujorin e pare te vitit 2010.

Megjithë permiresimin e ketij treguesi, krahasuar me disa vende te rajonit dhe te Europes, vendi yne vazhdon te jete shume larg standarteve europiane ne kete drejtim .(shih grafikun)

**Grafiku 7** Humbjet krahasuar me vendet e tjera te Europes



Burimi: ERRU, DPUK, dhe NUS

### Konsumi i matur

Ne sektorin e sherbimit te furnizmit me uje jo te gjithë konsumatorët paguajnë për atë që ata realisht konsumojnë. Deri tani vetëm rreth 45 % e sasisë së ujit të konsumuar matet .

Pjesa më e madhe e operatorëve kryejnë faturimin e klientëve të tyre me matës dhe afrofe. Shumë operatorë nuk kanë instaluar matës të konsumit dhe faturimi bëhet afrofe dhe vetëm një numër i kufizuar i operatorëve ka vendosur matës të ujit për të gjithë konsumatorët.

Tendenca e ketij treguesi është në rritje, por ritmi i rritjes nga një vit në tjetrin është i vogël.

**Tabela 3** Konsumi i matur

| Vitet | Faturimi ne total<br>(000/m3) | Faturimi i matur<br>(000/m3) | Faturimi i matur<br>(%) | Tendenca |
|-------|-------------------------------|------------------------------|-------------------------|----------|
| 2008  | 86,089                        | 34,265                       | 40                      | ↗        |
| 2009  | 90,640                        | 37,607                       | 41                      | ↗        |
| 2010  | 122,501                       | 54,967                       | 45                      | ↗        |

Burimi: ERRU

Matja e konsumit është konsideruar nga ERRU si një nga drejtimet kryesore të rregullimit në sektor.

Mungesa e matësve bën që konsumatorët të mos kenë një stimul për të kufizuar konsumin e ujit të pijshëm. Konsumatorët e shpërdorojnë atë duke e përdorur edhe për qëllime të tjera. Matja e konsumit ndikon në menaxhimin efikas të ujit si dhe vlerësimin real të humbjeve.

Si një hap i parë në këtë drejtim, ERRU në zbatimin e akteve ligjore në fuqi, u kerkoi të gjithë operatorëve pajisjen me matës të konsumatorëve jo familjare brenda vitit 2010.

Njohja e situates aktuale dhe paisja me mates e konsumatoreve hap pas hapi mbeshtetur ne plane afatgjata dhe afatshkurtra do t'u krijonte mundesi operatoreve per gjetjen e burimeve financiare dhe arritjen e ketij objekti.


### ***Norma e arketimit***

Arketimi i te ardhurave si burimi kryesor financiar ka qene ne qender te vemendjes per te gjithë operatorët ne sektor. Fakti qe pothuajse te gjithë operatorët e kane rritur normen e arketimit nga viti ne vit tregon vleresimin qe ata i kane bere ketij treguesi.

Permiresimi i sherbimit, krijimi i lehtesive ne pagesa, modernizimi i zyrave te marredhenieve me klientin dhe vendosja e tyre ne pika strategjike, apo edhe mundesia per te paguar detyrimet nepermjet llogarive bankare si dhe ndermarrja e masave detyruese, nderprerja e furnizimit me uje per konsumatorët problematike deri ne paditjen e tyre ne gjykate, jane faktore qe kane ndikuar ne permiresimin e ketij treguesi.

Disa operatore kane nje norme arketimi me te madhe se 100%, gje e cila tregon se po punojne per uljen e debitoreve duke mbledhur te ardhura te pa arketuara nga periudhat paraardhese. Grafiku i meposhtem jep nje pasqyre te qarte te gjendjes se arketimeve nga operatorët

**Grafiku 8**



*Burimi: Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPT, (Viti 2010)*

### ***Mbulimi i Kostos Operative dhe Kostos Totale***

Operatorët qe kryejne sherbimin e furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura pergjithesisht nuk i mbulojne koston e sherbimeve qe kryejne me te ardhurat e tyre.

Nje pjese e vogel e operatoreve kane synuar te mbulojne koston totale te sherbimeve me te ardhurat nga aktiviteti. Pjesa me e madhe e operatoreve kane synuar mbulimin e koston operative. Per operatorët e vegjel tendenca eshte vetem permiresimi i situates pasi me te ardhurat e tyre ata nuk mbulojne as 50% te shpenzimeve qe kryejne.

Buxheti i shtetit ka vazhduar te subvencionoje operatorët per mbulimin e kostove.

Nga analiza rezulton se tendenca per mbulimin e koston operative apo dhe te koston totale me te ardhurat nga sherbimi i furnizimit me uje dhe kanalizimeve eshte ne rritje.

Situata eshte me negative nese do te analizojme mbulimin e kostove (operative apo totale) sipas arketimeve.

Tabela 4

Analiza e mbulimit te kostove

|                            | 2008  | 2009  | 2010 | Trendenca |
|----------------------------|-------|-------|------|-----------|
| Mbulimi i KDO - te Ardhura | 64.95 | 69.30 | 114  | ↗         |
| Mbulimi i KTO - te Ardhura | 47.78 | 50.23 | 80   | ↗         |
| Mbulimi i KDO - Arketime   | 52.59 | 54.44 | 78   | ↗         |
| Mbulimi i KTO- Arketime    | 38.99 | 39.46 | 56   | ↗         |

Dy elementet kryesore te percaktimit te ketyre treguesve jane te ardhurat dhe shpenzimet.


Per te arritur rezultat pozitiv ne mbulimin e kostove nuk mjafton vetem rritja e te ardhurave, e rendesishme eshte edhe mbajtja nen kontroll e nivelit dhe struktures se shpenzimeve.

Kosto e sherbimit te furnizimit me uje ze 75-80% te shpenzimeve qe kryejne shoqerite UK.

Struktura e shpenzimeve per sherbimin e furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura paraqitet ne grafikun e meposhtem.

Grafiku 9

Struktura e shpenzimeve per sherbimet ne sektorin UK



Nga analiza e zerave te kosos rezulton se kostot qe zene peshe specifike me te madhe ne totalin e kosos jane kostot e personelit, te energjise elektrike dhe amortizimit.

Sherbimi i furnizimit me uje vazhdon te kryhet me nivel te larte shpenzimesh per personelin. Ketu nje ndikim te madh ka numri i larte i punonjesve per 1000 lidhje. Sipas te dhenave te ERRU dhe te Benchmark-ut, numri mesatar i punonjesve per 1000 lidhje aktualisht eshte 13.8 punonjes. Ky tregues krahasuar me periudhen paraardhese ka rritje. Krahasuar me vendet e rajonit ku numri mesatar i punonjesve per 4-5 punonjes per 1000 lidhje, ky tregues vazhdon te mbetet mjaft i larte.

Per shume operatore numri i punonjesve per 1000 lidhje eshte shume me i larte se mesatarja e vendit (30 punonjes per 1000 lidhje), por ka edhe operatore qe kane miremenaxhuar burimet njerezore dhe kete tregues e kane ne nivele te mira. Keta operatore kane me pak se 6 punonjes per 1000 lidhje.

Kosto e energjise elektrike ne totalin e shpenzimeve per furnizimin me uje ze nje peshe te konsiderueshme sidomos per ato shoqeri qe kane sistem me ngritje mekanike. Faktor i rendesishem qe lidhet me kete shpenzim eshte edhe niveli i larte i humbjeve. Per te siguruar furnizimin me uje te klienteve per shkak te nivelit te larte te humbjeve, shoqerite detyrohen te prodhojne me shume uje se sa nevoja, gje e cila ndikon direkt ne konsumin e energjise elektrike.

Shpenzimet per energji elektrike jane rritur edhe per sherbimin e largimit e perpunimit te ujrave te ndotura, sidomos per ata operatore qe administrojne edhe impiantet e trajtimit.

Kosto e amortizimit po behen nje element i rendesishem ne koston e shume operatoreve ku jane kryer apo po kryen investime per reabilitimin dhe zgjerimin e sistemit te ujesjelles kanalizime.

Perfundimi i investimeve dhe rregjistrimi i tyre ne asetet e shoqerise , per shkak te vlerave te larta qe ato kane kane rritur ndjeshem koston e sherbimit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura. Shpenzimet e amortizimit te llogaritura per keto asetete jane shume here me te larta se me pare.

Kosto e materialeve dhe mirembajtjes nuk zene nje vend te rendesishem ne strukturen e koston, por tendenca e tyre eshte ne rritje.

Investimet ne kete sektor kane sjelle ndyshimin e kostove te operimit dhe mirembajtjes ne teresi si dhe ndryshimin e strukture se koston. Rikonstruksioni i sistemeve te largimit te ujrave te ndotura, ndertimi i impianteve per perpunimin e ujrave te ndotura po ndryshojne koston e operimit dhe mirembajtjes.

Burimi kryesor i te ardhurave per operatoret jane te ardhurat qe realizohen nga sherbimi i furnizimit me uje dhe largimi e perpunimi i ujrave te ndotura. Por per shume operatore nje vend te rendesishem ne totalin e te ardhurave zene edhe subvencionet.

Ne percaktimin e ketyre te ardhurave nje vend te rendesishem ze niveli i faturimit, arketimit si dhe tarifat.

Rritja e nivelit te faturimit , ulja e nivelit te humbjeve , permiresimi i strukture tarifore po bejne qe sektori te gjeneroje me shume te ardhura. Struktura e te ardhurave paraqitet me poshte.

**Tabela 5** Struktura e te ardhurave te operatoreve UK ne vite.

|             | Te ardhurat | Subvencioni |
|-------------|-------------|-------------|
| <b>2008</b> | 3,518,076   | 1,417,189   |
| <b>2009</b> | 3,752,558   | 848,595     |
| <b>2010</b> | 5,615,486   | 2,400,000   |

Burimi: DPUK,MPPTT

Nje rol te rendesishem ne permiresimin e situates ne sektor kane luajtur investimet e kryera gjate vitit 2010. Burimi kryesor i investimeve ne sektor kane qene fondet e Buxhetit te Shtetit si dhe financimet nga donatoret e huaj ne forme kredie ose grantesh. Investimet kryesisht jane perqendruar ne rehabilitimin e sistemeve te ujesjelles – kanalizimeve si dhe per ndertimin e impianteve te trajtimit te ujrave te ndotura. Gjithashtu nje pjese e tyre po perdoret edhe per instalimin e matesave te ujit ne prodhimin e ujit te pijshem si dhe tek konsumatoret. Tabela e meposhtme jep trendin rrites te investimeve ne kete sektor.

**Tabela 6** Investimet ne sektorin UK

| Viti        | Buxheti i Shtetit<br>(milion / leke) | Donatoret e huaj<br>(milion / leke) |
|-------------|--------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>2008</b> | 3,228                                | 4,286                               |
| <b>2009</b> | 4,780                                | 4,079                               |
| <b>2010</b> | 6,544                                | 3,228                               |

Burimi: DPUK, MPPT

#### 4. Kendveshtrimi per vitin 2011

Viti 2011 do te jete viti i konsolidimit te metejshe te ERRU dhe permiresimi i kuadrit rregullator ne sektorin e sherbimeve UK.

Per sa me siper, ERRU do te zhvilloje veprimtarite dhe aktivitetet e meposhtme:


- Te perfundoje dhe te zbatoje Metodologjine e re te vendosjes se tarifave
- Te shqyrtoje me objektivet dhe transparence te gjitha aplikimet per ndryshim te tarifave te sherbimit ne sektorin UK
- Te aprovoje kontraten model ndermjet Konsumatorit dhe Operatorit dhe te mbikqyre procesin e zbatimit te tyre ne praktike
- Te zhvilloje ne partneritet dhe te aprovoje procesin e studimit mbi statusin e sherbimit ndaj Konsumatorit
- Te zhvilloje ne partneritet procesin e pergatitjes se manualit per Anetaret e Keshillave Mbikqyres
- Te vazhdoj procesin e licencimit te te gjitha ofruesve aktuale te sherbimit ne sektorin UK
- Te beje rregullimet e duhura ne kuadrin ligjor per licencimin e ofruesve te sherbimit duke synuar mbulimin e te gjitha sistemeve UK me nje sherbim te licencuar.
- Te mbeshtese procesin e hartimit dhe zbatimit te Strategjise se sektorit UK.
- Te mbeshtese dhe te mbikqyre procesin e pergatitjes se planeve te biznesit per te gjitha operatoret e sherbimit.
- Te vazhdoj dhe konsolidoj bashkepunimin me donatoret dhe te gjitha aktoret ne sektorin UK.
- Te zhvilloje ne partneritet standartet minimale te sherbimit.
- Te zhvilloje ne partneritet "Perceptimin e Konsumatoreve per Cilesine e Sherbimit".



## 5. Rekomandime

- Te permiresohen treguesit e performances se operatoreve te sherbimit sidomos ato ne lidhje me cilesine e sherbimit, vijueshmerine dhe zgjatjen kohes se furnizimit me uje, rritjen e zonave te sherbimit dhe te numrit te konsumatoreve, cilesine e ujit si dhe trajtimin te ujrave te ndotura. Monitorimi i ketyre treguesve do te jete mire te drejtohet nga ERRU ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Operoret qe aktualisht mbulojne kostot e O&M duhet te synojne mbulimin e kostos totale te ketij sherbimi. Operoret qe aktualisht nuk i mbulojne kostot e O&M duhet te synojne mbulimin e tyre.
- Te rritet roli dhe pergjegjesia e Keshillave Mbikqyres si dhe njesive te Qeverisjes Vendore ne drejtim te permiresimit te cilesise se sherbimit ne kete sektor.
- Te rishikohet riorganizimi i disa operatoreve te vegjel te cilet rezultojne me probleme mjaft te medha dhe paaftesi te theksuar ne lidhje me kapacitetet e tyre teknike, administrative dhe ekonomike.
- Te rritet kapaciteti tekniko / profesional i operatoreve te sherbimit duke synuar uljen e punonjesve per 1000 lidhje.
- Te permiresohet puna ne marredheniet e operatoreve me konsumaret duke u pergenduar ne riorganizimin dhe permiresimin e sistemit te komunikimit te operatoreve me konsumaret si dhe te zyrave te ankesave.
- Operoret duhet te jene aktive ne procesin e zbatimit te kontratave te reja model ndermjet tyre dhe Konsumatoreve i cili do te jete nje proces transparent i udhehequr nga ERRU.
- Te aprovohet nje strategji e qarte e sektorit per nje periudhe 5 vjeçare ku te synohet ne permiresimin e menaxhimit te sektorit UK si dhe te cilesise se sherbimit ne kete sektor
- Te vazhdoje Bashkepunimi i hapur ndermjet institucioneve qe jane te perfshira ne sherbimin e furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrave te ndotura
- Investimet ne sektorin UK duhet te synojne ne permiresimin e treguesve te performances. Ato duhet te shoqerohen me plane veprimi te qarta dhe afatgjate per rezultatet dhe permiresimet e duhura
- Dhenia e subvencioneve per operoret e sherbimit UK duhet te behet ne baze te treguesve te performances per secilin prej tyre. Ky proces duhet te behet ne bashkepunim te plote me ERRU
- Te perfundoje instalimi i matesave te ujit ne prodhim dhe te vazhdoje me ritme me te shpejta instalimi i matesave te ujit per konsumaret familjare
- Te permiresohet sistemi i mbrojtjes sanitare te burimeve te furnizimit me uje
- Te permiresohet sistemi i monitorimit te cilesise se ujit duke synuar pajisjen e operatoreve te medhenj me labororet perkates per monitorimin e cilesise se ujit.
- Te hartohet formati standart per “Bilancin te Ujit”.

## ANEKSI 1

**STRUKTURA E ENTIT RREGULLATOR TE SEKTORIT TE FURNIZIMIT ME UJE DHE LARGIMIT E PERPUNIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA (ERRU)**

## ANEKSI 2

## Zonat e sherbimit te operatoreve te licencuar

| Te licencuar              | Zonat e sherbimit sipas VKM Nr. 660 date 12.09.2007, VKM Nr. 81 dt.12.02.2004, VKM Nr. 173 dt. 26.03.2004 dhe VKM Nr. 809 dt. 26.11.2004.                                             |
|---------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Sh.a UK Berat - Kuçove    | Bashkia: Berat; Komuna: Vertop, Otlak, Bashkia Kuçove, Komuna: Kozare, Perondi                                                                                                        |
| Sh.a U Bilisht            | Bashkia: Bilisht                                                                                                                                                                      |
| Sh.a U Bulqize            | Bashkia: Bulqize; Komuna Shupenze (pjes.)                                                                                                                                             |
| Sh.a U Burrel ose Mat     | Bashkia: Burrel; Komuna: Lis                                                                                                                                                          |
| Sh.a UK Delvine           | Bashkia: Delvine; Komuna: Mesopotam (F.Bistrice)                                                                                                                                      |
| Sh.a UK Durres            | Bashkia: Durres, Shijak, Vore, Sukth, Manez; Komuna: Thumane, Ishem, Xhafzotaj, Rrashbull, Katund i Ri, Bubq, Preze, Fushe-Kuqe, Maminas, Gjepalaj                                    |
| Sh.a U Elbasan Fshat      | Bashkia: Cerrik, Belsh; Komuna: Grekan, Gostime, Shales, Kajan, Rase, Fierze, Paper, Gjergjan, Mollas, Bradashesh, Gracen, Zavaline, Labinot Fushe, Labinot, Mal, Shirgjan, Shushice. |
| Sh.a UK Erseke            | Bashkia: Erseke                                                                                                                                                                       |
| Sh.a UK Fier              | Bashkia: Fier, Roskovec, Divjake; Komuna: Topoje, Seman, Dermenas, Levan, Frakull, Kuman.                                                                                             |
| Sh.a U Gramsh             | Bashkia: Gramsh; Komuna: Tunje, Sult, Pishaj, Kushove, Kodovjak                                                                                                                       |
| Sh.a U Has                | Bashkia: Krume; Komuna: Fajza, Gjinaj                                                                                                                                                 |
| Sh.a UK Kavaje            | Bashkia: Kavaje; Komuna: Helmes, Kryevidh, Golem, Lekaj, Luz i Vogel, Synej                                                                                                           |
| Sh.a. UK Korçe Qytet      | Bashkia: Korçe                                                                                                                                                                        |
| Sh.a UK Kruje             | Bashkia: Kruje; Komuna: Cudhi                                                                                                                                                         |
| Sh.a U Kukes              | Bashkia: Kukes; Komuna: Shtiçen, Bicaç                                                                                                                                                |
| Sh.a UK Lezhe             | Bashkia: Lezhe; Komuna: Shengjin, Balldren                                                                                                                                            |
| Sh.a UK Librazhd          | Bashkia: Librazhd, Perrenjas; Komuna: Rrajce (pjes.), Qender                                                                                                                          |
| Sh.a UK Lushnje Qytet     | Bashkia: Lushnje                                                                                                                                                                      |
| Sh.a U Patos              | Bashkia: Patos; Komuna: Cakran, Portez                                                                                                                                                |
| Sh.a UK Peqin             | Bashkia: Peqin; Komuna: Sheze                                                                                                                                                         |
| Sh.a U Permet             | Bashkia: Permet; Komuna: Petran                                                                                                                                                       |
| Sh.a U Peshkopi           | Bashkia: Peshkopi; Komuna: Kala e Dodes, Slllove, Fushe Cidhen, Luzi, Kastriot, Qender Tomin.                                                                                         |
| Sh.a UK Pogradec          | Bashkia: Pogradec; Komuna: Buçimas                                                                                                                                                    |
| Sh.a U Poliçan            | Bashkia: Poliçan; Komuna: Vendreshe, Bogove                                                                                                                                           |
| Nderm. UK, Bashkia Puke   | Bashkia: Puke                                                                                                                                                                         |
| Sh.a UK Rreshen (Mirdite) | Bashkia: Rreshen; Komuna: Selite, Orosh                                                                                                                                               |
| Sh.a UK Rrogozhine        | Bashkia: Rrogozhine; Komuna: Gose, Sinaballaj                                                                                                                                         |
| Sh.a UK Rubik             | Bashkia: Rubik                                                                                                                                                                        |

|                                              |                                                                                                                                                          |
|----------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Sh.a UK Sarande</b>                       | Bashkia: Sarande; Komuna: Dhiver, Aliko, Mesopotam, Finiq                                                                                                |
| <b>Sh.a U Skrapar</b>                        | Bashkia: Corovode; Komuna: Qender, Gjerbes, Potom, Cepan, Vendresh, Bogove, Zhepe                                                                        |
| <b>Sh.a U Tepelene</b>                       | Bashkia: Tepelene, Memaliaj; Komuna: Qender Tepelene, Qender Memaliaj, Krahes, Qesarat, Kurvelesh                                                        |
| <b>Sh.a UK Tirane</b>                        | Bashkia: Tirane, Kamez, Vore; Komuna: Berzhite, Shengjergj, Preze, Petrele, Dajt, Baldushk, Paskuqan, Zall Herr, Kashar, Farke, Krrabe, Berxull, Vaqarr. |
| <b>Sh.a U Tropoje</b>                        | Bashkia: Bajram Curri; Komuna: Margegaj, Tropoje, Bujan, Llugaj, Fierze, Bytyc                                                                           |
| <b>Sh.a U Vlore</b>                          | Bashkia: Vlore, Himare; Komuna: Shushice, Armen, Qender, Kote                                                                                            |
| <b>Sh.a U Selenice</b>                       | Bashkia: Selenice                                                                                                                                        |
| <b>Sh.a UK Gjirokaster (qytet)</b>           | Bashkia: Gjirokaster; Komuna: Lunxheri                                                                                                                   |
| <b>Sh.a UK Shkoder (qytet)</b>               | Bashkia: Shkoder                                                                                                                                         |
| <b>Nderm. Ujesjelles Gjirokaster (Fshat)</b> | Komuna: Lunxheri (pjes), Qender Libohove, Lazarat, Cepo, Antigone, Odrie, Picar, Zagori, Dropull i Siperim, Dropull i Poshtem.                           |
| <b>Sh.a U Novosele</b>                       | Komuna: Novosele                                                                                                                                         |
| <b>Sh.a U Shkoder (Fshat)</b>                | Komuna: Berdise, Velipoje, Hajmel, Gur i Zi, Ana e Malit, Shale, Rrethina                                                                                |
| <b>Sh.a U Kurbin</b>                         | Bashkia: Laç, Mamurras; Komuna: Milot                                                                                                                    |
| <b>Sh.a U Orikum</b>                         | Bashkia: Orikum                                                                                                                                          |
| <b>Sh.a UK Kraste</b>                        | Komuna: Martanesh                                                                                                                                        |

## ANEKSI 3



Tarifat aktuale sipas llojit te sherbimit (lek/m<sup>3</sup>)

| Nr | Lloji i shoqerise | Emertimi             | Per Ujin e Pijshem |          |        |                       |                  |               |              | Per Ujin e Ndotur |          |        |
|----|-------------------|----------------------|--------------------|----------|--------|-----------------------|------------------|---------------|--------------|-------------------|----------|--------|
|    |                   |                      | Familjar           | Buxhetor | Privat | Shitje Uji me shumice | Kliente specifik | Cezma Publike | Tarife fikse | Familjar          | Buxhetor | Privat |
| 1  | Sha UK            | Berat                | 35                 | 110      | 110    |                       |                  |               |              | 8                 | 14       | 16     |
| 2  | Sha U             | Bilisht              | 32                 | 75       | 90     |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 3  | Sha U             | Bulqize              |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 4  | Sha U             | Burrel (Mat )        | 23                 | 60       | 80     |                       |                  |               |              | 2                 | 4        | 6      |
| 5  | Sha UK            | Delvine              | 48                 | 100      | 100    |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 6  | Sha U             | Divjake              |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 7  | Sha U             | Durres               | 45                 | 90       | 110    | 245 / 24 / 26         |                  |               | 100          | 12                | 15       | 15     |
| 8  | Sha UK            | Elbasan (Elber shpk) | 38                 | 115      | 130    |                       | 2726             |               |              | 83                | 25       | 30     |
| 9  | Sha U             | Elbasan Fshat        | 30                 | 80       | 80     | 25/ 6                 |                  |               | 100          |                   |          |        |
| 10 | Sha U             | Erseke               | 32                 | 60       | 80     |                       |                  |               |              | 6                 | 6        | 8      |
| 11 | Sha UK            | Fier                 | 44                 | 80       | 100    | 22 / 60               |                  |               | 100          | 10                | 12       | 14     |
| 12 | Sha UK            | Fushe Arrez          |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 13 | Sha UK            | Fushe kruje          | 28                 | 60       | 80     |                       |                  |               |              | 6                 | 10       | 12     |
| 14 | Sha UK            | Gjirokaster          | 28                 | 85       | 110    | 22                    |                  |               | 50           | 6                 | 8        | 12     |
| 15 | Sha U             | Gjirokaster Fshat    | 25                 | 60       | 60     |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 16 | Sha U             | Gramsh               | 28.5               | 70       | 85     |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 17 | Sha U             | Has                  | 25                 | 60       | 80     |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 18 | Sha UK            | Kavaje               | 38                 | 80       | 100    | 298                   |                  |               | 100          | 15                | 20       | 20     |
| 19 |                   | Kelcyre              |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 20 | Sha UK            | Korce                | 50                 | 85       | 114    |                       |                  |               | 80           | 20                | 35       | 37     |
| 21 | Sha U             | Korce Fshat          |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 22 | Sha U             | Kraste               | 30                 | 80       | 100    |                       |                  |               |              | 7                 | 10       | 15     |
| 23 | Sha UK            | Kruje                | 33                 | 80       | 80     |                       |                  |               |              | 8                 | 12       | 12     |
| 24 | Sha UK            | Kucove               | 36                 | 110      | 110    |                       |                  |               |              | 8                 | 14       | 16     |
| 25 | Sha U             | Kukes                | 25                 | 60       | 80     | 15                    |                  |               |              | 7                 | 15       | 20     |
| 26 | Sha U             | Kurbin               | 30                 | 80       | 120    |                       |                  |               | 50           |                   |          |        |
| 27 | Sha UK            | Lezhe                | 43                 | 100      | 110    | 26                    |                  |               |              | 10                | 14       | 17     |
| 28 |                   | Libohove             |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 29 | Sha UK            | Librazhd             | 34                 | 80       | 90     | 28                    |                  |               |              | 10                | 15       | 17     |
| 30 | Sha UK            | Lushnje              | 44                 | 100      | 110    | 32                    |                  |               | 100          | 12                | 16       | 18     |
| 31 | Sha U             | Lushnje Fshat        | 60                 |          | 100    |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 32 |                   | Mallakaster          |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 33 | Sha U             | Malsia e Madhe       |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 34 | Sha UK            | Mirdite (Rreshen)    | 25                 | 60       | 80     |                       |                  |               |              | 4                 | 8        | 10     |
| 35 | Sha U             | Novosele             | 33                 | 50       | 70     |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 36 | Sha U             | Orikum               |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 37 | Sha U             | Patos                |                    |          |        |                       |                  |               |              |                   |          |        |
| 38 | Sha UK            | Peqin                | 30                 | 90       | 100    |                       |                  |               | 50           |                   |          |        |
| 39 | Sha U             | Permet               | 38                 | 100      | 120    |                       |                  |               | 50           |                   |          |        |


|    |            |                  |    |     |     |       |             |    |     |    |    |    |
|----|------------|------------------|----|-----|-----|-------|-------------|----|-----|----|----|----|
| 40 | Sha U      | Peshkopi         | 27 | 65  | 85  |       |             | 24 |     |    |    |    |
| 41 | Sha UK     | Pogradec         | 55 | 110 | 110 |       |             |    | 40  | 18 | 25 | 25 |
| 42 | Sha U      | Polican          | 37 | 80  | 95  |       |             |    |     |    |    |    |
| 43 | Sha UK     | Puke             | 25 | 60  | 80  |       |             |    |     | 5  | 8  | 10 |
| 44 | Sha U      | Rrogozhine       | 45 | 80  | 90  |       |             |    |     | 8  | 10 | 10 |
| 45 | Sha UK     | Rubik            | 30 | 70  | 100 |       |             |    |     | 7  | 10 | 15 |
| 46 | Sha UK     | Sarande          | 40 | 90  | 110 | 25    |             |    | 100 | 14 | 20 | 20 |
| 47 | Sha U      | Selenice         | 30 | 80  | 100 | 25    |             |    |     |    |    |    |
| 48 | Sha UK     | Shkoder          | 35 | 95  | 100 |       |             |    | 50  | 13 | 16 | 16 |
| 49 | Sha U      | Shkoder<br>Fshat |    |     |     |       |             |    |     |    |    |    |
| 50 | Sha U      | Skrapar          | 27 | 80  | 95  |       |             |    |     |    |    |    |
| 51 | Sha U      | Tepelene         | 33 | 100 | 120 |       |             |    |     |    |    |    |
| 52 | Sha UK     | Tirane           | 33 | 110 | 120 | 10/ 5 | 140 /<br>95 |    | 100 | 10 | 25 | 25 |
| 53 | Sha U      | Tropoje          | 19 | 60  | 80  |       |             |    |     |    |    |    |
| 54 | Sha U      | Ura<br>Vajgurore | 40 | 90  | 100 |       |             |    |     |    |    |    |
| 55 | Ndermarrje | Vau i Dejes      |    |     |     |       |             |    |     |    |    |    |
| 56 | Sha U      | Vlore            | 30 | 60  | 80  |       |             |    |     |    |    |    |

## ANEKSI 4

Ecuria e tarifave mesatare sipas sherbimeve ne 5 vitet e fundit:



## ANEKSI 5.1





## ANEKSI 5.2

